



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prillogje Në/Dana 03-05-2024 vit/god			
Nr./ organit Org. broj	Numri/Broj	Shitje Prilog	Vlera Vendnoet
12-	035/02-		688



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

Komisioni për ankesa në përbërje, Avdirrahman Sadiku (kryesues i komisionit), Arian Alidema (anëtar), Fatlum Demiri (anëtar), në mbledhjen e mbajtur me datën 03.05.2024, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ankesës, si: ankesën e OJQ Qendra Kulturore Artistike "ANAMORAVA" me Nr.12-320/04-13336, e datës 29.04.2024, kundër Vendimit të listës preliminare të komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Nr. 12-035/02-639, i datës 22.04.2024, në përputhje me neni 9 dhe 21 të Rregullores MF – Nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, komisioni merr këtë:

## V E N D I M

1. **Refuzohet si e pabazuar** Ankesa e OJQ Qendra Kulturore Artistike "ANAMORAVA" Nr.12-320/04-13336, e datës 29.04.2024, kundër Vendimit të listës preliminare të komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Nr. 12-035/02-639, i datës 22.04.2024
2. **Mbetet në fuqi** Vendimit i listës preliminare të komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Nr. 12-035/02-639, i datës 22.04.2024

### Arsyetim

Komisioni për ankesa, në mbledhjen e mbajtur me datën 03.05.2024 shqyrtoj ankesën e OJQ Qendra Kulturore Artistike "ANAMORAVA" me Nr.12-320/04-13336, e datës 29.04.2024, kundër Vendimit të listës preliminare të komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Nr. 12-035/02-639, i datës 22.04.2024, të publikuar nga komisioni prej 5 anëtarëve, me pretendime për paknaqësinë me përkrahjen që i është bërë në lidhje me shumën financiare të miratuar nga komisioni vlerësues.

Komisioni i ankesave, bazuar në vlerësimet e hollësishme të çdo prove veç e veç dhe çdo prove së bashku, si dhe bazuar në rezultatet e tërësishme të shqyrtimit administrativ, konstatoj se, ankesa OJQ Qendra Kulturore Artistike "ANAMORAVA" Nr.12-320/04-13336, e datës 29.04.2024 është e pabazuar, sepse:

- Kryetari i komisionit për ankesa, Avdirrahman Sadiku, me datën 03.05.2024 ka kërkuar nga anëtarët e komisionit vlerësues dokumentacionet, konkretisht aplikacionin e OJQ Qendra Kulturore Artistike "ANAMORAVA".
- Komisioni për shqyrtimin e ankesave, gjatë shqyrtimit të ankesave, konkretisht ankesës e OJQ Qendra Kulturore Artistike "ANAMORAVA" Nr.12-320/04-13336, e datës 29.04.2024, konstaton që, komisioni vlerësues për ndarjen e subvencioneve të drejtorisë ka qenë i themeluar konform Rregullores MF Nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
- Komisioni vlerësues ka respektuar neni 4 të Rregullores MF – Nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, konkretisht parimet e përgjithshme, duke respektuar konkurrueshmërinë, trajtimin e barabartë dhe mos diskriminimin e aplikuesve, transparenca në procedura e parimet e tjera konform neni të cekur më lartë.
- Komisioni i ankesave konsideron dhe vlerëson se komisioni për ndarjen e subvencioneve, duke vlerësuar e analizuar aplikacionin e OJQ Qendra Kulturore Artistike "ANAMORAVA" ka vendosur drejt, sipas



thirrjes publike, bugjetit të Drejtoris së DKRS-ë, në përputhje me proceduart sipas Rregullores 04/2017 dhe është në diskrecionin e komisionit vlerësues mbështetja financiare bazuar në aplikacionin dhe aktivitetet e parapara të OJQ Qendra Kulturore Artistike "ANAMORAVA".

Andaj, mbi bazën e të gjeturave dhe konstatimeve si më lartë, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, në përputhje me Ligjin mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 dhe Rregullores MF-04/2017, duke pasur parasysh interesin publik dhe ofrimin e mbështetjes për OJQ-të të cilat kontribuojnë në jetën e përditshme kulturore, sportive etj, dhe me qëllim të respektimit të ligjshmërisë, financimin përmes fondeve publike të projekteve dhe programeve që janë me prioritet, dhe në mënyrë të drejtë dhe transparente, të barabartë me kritere të qarta, duke respektuar dyshkallshmërinë, parimet e llogaridhënies dhe ruajtjen e pavarësisë së përfituesve, ka ardhë në përfundim dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilla Juridike:** Vendimi i komisionit të ankesave është vendim përfundimtar në procedurën administrative, andaj palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese në afat prej 30 dite nga data e njoftimit në web faqen e komunës, pran Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative.

Vendimi ju dërzohet:

1. OJQ-së ankuese;
2. Komisionit vlerësues;
3. Komisionit të ankesave;
4. Arhivës komunale:

Viti, më 03.05.2024

Avdirrahman Sadiku, kryesues i komisionit

Arian Alidema, anëtar

Fatlum Demiri, anëtar

